# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8298
E shtunë, 9 maj 2026
Çmimi 0. 50 €


## Haxhiu dekreton një sërë ligjesh të rëndësishme për qytetarët dhe shtetin

FAQE 5





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


PËRMBYLLET AFATI PËR PARTITË POLITIKE PËR PJESËMARRJE NË ZGJEDHJE DHE PËR DEKLARIMIN E KOALICIONEVE PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 7 QERSHORIT

# 22 PARTI E TRI KOALICIONE DO TË GAROJNË NË ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT

FAQE 4-5



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se më 7 maj është përmbyllur afati për partitë politike të regjistruara në Kosovë për pjesëmarrje ose mospjesëmarrje në zgjedhje dhe formim të koalicioneve. Gjatë periudhës 7-ditore, KQZ-ja ka pranuar njoftimin për pjesëmarrje në zgjedhje nga 22 parti politike, mospjesëmarrje nga 9 parti politike dhe 3 koalicione. Këto do të jenë zgjedhjet e treta parlamentare brenda 18 muajsh, pas atyre në shkurt dhe dhjetor 2025



### ANTONOV NË KOSOVË: KREJT ÇFARË DIHET PËR FLUTURIMIN E AVIONIT TË MADH TRANSPORTUES

F. 5



### SA E RREZIKOJNË LDK-në TENSIONET NË PRISHTINË?

F. 3

## AKTUALE



### LIMAJ I ÇON LETËR HAMZËS, KËRKON QË NISMA TË JETË NË LISTËN E PDK-SË PËR ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT

F. 5

### KRYEPROKURORI ISUFAJ PRET NË TAKIM PERSONALITETE TË NJOHURA AMERIKANE DHE NDËRKOMBËTARE NGA FUSHA E DREJTËSISË

F. 6

### KUSARI-LILA: QYTETARËT E KOSOVËS NDËR POPUJT MË PRO-EVROPIANË NË BALLKAN

F. 7

## EKONOMI



### BQK, ATK, NJIF-K DHE IQMT FORCOJNË KOORDINIMIN PËR INTEGRITETIN E SISTEMIT FINANCIAR

F. 8

### MË SHUMË VIZITORË NË HOTELE NË MARS 2026 KRAHASUAR ME NJË VIT MË PARË

F. 8

## SPORT



### DRITA SOT MUND TË SHPALLET KAMPIONE E SUPERLIGËS

F. 11


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# TRUMPI THOTË SE ARMËPUSHIMI ËSHTË ENDE NË FUQI, PAS PËRSHKALLËZIMIT TË LUFTIMEVE MES SHBA-SË DHE IRANIT

**Uashington, 8 maj** - Forcat amerikane dhe iraniane u përleshën në Gjirin Persik të enjten vonë, ndërsa Emiratet e Bashkuara Arabe u goditën sërish nga sulme ajrore, duke e rrezikuar armëpushimin njëmujor dhe duke zbehur shpresat për zgjidhjen e konfliktit në mënyrë diplomatike.

Përshkallëzimi i luftimeve ndodhi ndërkohë që Uashingtoni po e priste një përgjigje nga Teherani lidhur me propozimin e tij për t'i dhënë fund konfliktit, i cili nisi me bombardime të përbashkëta amerikano-izraelite në mbarë Iranin më 28 shkurt.

Presidenti Donald Trump tha të premten se tri anije të marinës amerikane u sulmuan derisa po kalonin përmes Ngushticës së Hormuzit, rrugës jetike detare nëpër të cilën rrjedh rreth një e pesta e transportit botëror të naftës dhe gazit të lëngshëm natyror.

Irani e ka mbyllur pothuajse plotësisht këtë ngushticë që nga fillimi i konfliktit. "Tre shkatërrues amerikanë të klasit botëror sapo kaluan me shumë sukses përmes Ngushticës së Hormuzit, nën zjarr. Nuk pati dëme ndaj tre shkatërruesve, por dëme të mëdha ndaj sulmuesve iranianë", shkroi Trump në Truth Social.

Më vonë, Trump u tha gazetarëve se armëpushimi është ende në fuqi dhe u përpoq ta minimizonte shkëmbimin e zjarrit. "Ata u tallën me ne sot. Ne i shkatërruam", tha Trump në Uashington.

Komanda e përbashkët ushtarake e Iranit e akuzoi SHBA-në për shkelje të armëpushimit duke shënjestruar një cisternë iraniane të naftës dhe një anije tjetër, si dhe për kryerjen e sulmeve ajrore ndaj zonave civile në ishullin Qeshm në Ngushticën e Hormuzit dhe në zonat bregdetare në afërsi.

Ushtria iraniane tha se u përgjigj duke sulmuar anije ushtarake amerikane në lindje të ngushticës dhe në jug të portit Çabhar.

Një zëdhënës i Shtabit Qendror të Iranit, Khatam al-Anbiya, tha se sulmet iraniane shkaktuan "dëme të konsiderueshme", por Komanda Qendrore e SHBA-së deklaroi se asnjë nga asetet e saj nuk u godit.

Më vonë, televizioni iranian Press TV raportoi se, pas disa orësh shkëmbim zjarri, "gjendja në ishujt iranianë dhe qytetet bregdetare pranë Ngushticës së Hormuzit është kthyer në normalitet".

Të dyja palët kanë shkëmbyer herë pas here zjarr qëkurse armëpushimi hyri në fuqi më 7 prill. Irani ka goditur shënjestra në vendet e Gjirit, përfshirë Emiratet e Bashkuara Arabe.

Që nga fillimi i luftës, Irani ka shënjestruar shpesh Emiratet dhe vende të tjera të Gjirit që strehojnë baza amerikane.

Çmimet e naftës u rritën në tregtinë e hershme në Azi të premten, me naftën Brent që kaloi mbi 100 dollarë për fuçi pas përleshjeve të fundit.

### Trump kërkon që lufta të zgjidhet përmes bisedimeve

Trump la të kuptohet se bisedimet me Teheranin po vazhdonin sipas planit pavarësisht përleshjeve të së enjtes, duke u thënë gazetarëve: "Po negociojmë me iranianët".



Para sulmeve më të fundit, SHBA-ja kishte propozuar një plan që do t'i jepte fund zyrtarisht konfliktit, por i cili nuk trajtonte kërkesat kryesore amerikane që Irani ta pezullojë veprimtarinë bërthamore dhe ta rihapë ngushticën.

Teherani ka thënë se ende nuk e ka marrë vendimin si t'i përgjigjet propozimit amerikan.

Megjithatë, Trump tha se Teherani kishte pranuar kërkesën e tij që Irani të mos zotërojë kurrë armë bërthamore, një ndalim që, sipas tij, ishte i cekur qartë në propozimin amerikan. "Nuk ka asnjë mundësi. Dhe, ata e dinë këtë, dhe pajtohen me këtë. Të shohim nëse janë të gatshëm ta nënshkruajnë", tha Trump.

I pyetur se kur mund të arrihej ndonjë marrëveshje, Trump tha: "Mund të mos ndodhë, por mund të ndodhë secilën ditë. Besoj se ata duan marrëveshje më shumë se unë".

# OPERACION I MADH NË STAMBOLL - 29 TË ARRESTUAR PËR MANIPULIM TË TENDERËVE PUBLIKË, "BASHKËPUNËTORË" TË IMAMOGLUT

**Stamboll, 8 maj** - Në kuadër të një hetimi të zhvilluar nga Prokuroria e Përgjithshme e Stambollit ndaj asaj që e quan "organizatë kriminale për përfitim të drejtuar nga kryebashkiaku, Ekrem Imamoglu", janë arrestuar 29 persona nën dyshimet për manipulim të procedurave të tenderimit publik.

Sipas njoftimit zyrtar të prokurorisë, hetimet lidhen me veprimtari të dyshuara të një strukture kriminale të organizuar, e cila dyshohet se ka funksionuar përmes kompanisë Agaç ve Peyzaj A.Ş., një ndërmarrje e lidhur me bashkinë.

Autoritetet pretendojnë se përmes kësaj kompanie është krijuar një "sistem i sajuar tenderësh", me të cilin janë manipuluar procedurat e prokurimit publik dhe janë favorizuar subjekte të caktuara në mënyrë të paligjshme.

Në kuadër të operacionit janë lëshuar urdhra ndalimi për 30 persona, prej të cilëve 29 janë arrestuar, ndërsa një i dyshuar ndodhet jashtë vendit dhe për të vijon kërkimi.



Hetimet po vazhdojnë, ndërsa autoritetet nuk kanë dhënë ende detaje të tjera për identitetin e të arrestuarve apo për rolin e tyre të saktë në skemën e dyshuar.

Ndryshe, vitin e kaluar, kryetari i Stambollit dhe kandidati presidencial İmamoglu nga Partia Republikane Popullore (opozita), u ndalua nga policia turke nën dyshimet për korrupsion, zhvatje, ryshfet, pastrim parash, spiunazh dhe mbështetje të terrorizmit, veçanërisht të PKK-së.

## Kryeministri britanik pëson humbje të rëndë në zgjedhjet lokale

**Londër, 8 maj** - Kryeministri britanik, Keir Starmer ka pësuar humbje të mëdha në zgjedhjet e së premtes, gjë që tregon thellësinë e pakënaqësisë së votuesve ndaj qeverisë së tij dhe hap pyetje të reja për të ardhmen e tij politike, vetëm dy vite pas fitores së madhe në zgjedhjet e përgjithshme.




Partia e tij Laburiste ka humbur mbështetje në shumë zona ku janë shpallur rezultatet gjatë natës, duke përfshirë bastione tradicionale në rajonet e dikurshme industriale të Anglisë qendrore dhe veriore, si dhe në disa pjesë të Londrës.

Fituesi kryesor i zgjedhjeve ishte partia populiste kundër emigracionit Reform UK, e udhëhequr nga mbështetësi i BREXIT-it Nigel Farage.

Ajo ka fituar më shumë se 200 vende në këshillat lokalë në Angli dhe mund të bëhet forca kryesore opozitare në Skoci dhe Uells, përballë Partisë Nacionaliste Skoceze dhe Plaid Cymru.

Zgjedhjet për 136 këshilla lokalë në Angli, së bashku me zgjedhjet për parlamentet e decentralizuara në Skoci dhe Uells, përbëjnë testin më të rëndësishëm të opinionit publik para zgjedhjeve të ardhshme të përgjithshme që pritet të mbahen në vitin 2029.

Deputetët e Partisë Laburiste në pushtet thanë se Starmer mund të përballet me presione të reja për të dhënë dorëheqje ose për të përcaktuar një afat për largimin e tij, nëse partia performon keq në Skoci, humb pushtetin në Uells dhe nuk arrin të mbajë një numër të madh nga rreth 2500 vendet e këshilltarëve që mbron në Angli.

Rezultatet e hershme tregojnë një dobësim të mëtejshëm të sistemit tradicional dy-partiak britanik dhe kalim drejt një demokracie shumë-partiake, që analistët e konsiderojnë si një nga transformimet më të mëdha politike në 100 vitet e fundit, shkruan skynews.

Partitë dikur dominuese, Laburistët dhe Konservatorët, po humbin vota në favor të Reform UK, ndërsa në krahun tjetër të spektrit politik po forcohet Partia e Gjelbër, dhe pritet që partitë nacionaliste të fitojnë në Skoci dhe Uells.

Farage tha se rezultatet deri tani tejkalojnë pritjet e tij dhe përfaqësojnë një ndryshim historik në politikën britanike.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# SA E RREZIKOJNË LDK-në TENSIONET NË PRISHTINË?

Në prag të zgjedhjeve të 7 qershorit, LDK-ja po synon ta bashkojë të djathtën, por marrëveshja e Përparim Ramës me PDK-në në Prishtinë ka nxjerrë në pah tensione dhe mungesë koordinimi brenda partisë. A rrezikon kjo përplasje ta zbehë narrativin e unitetit që po përpiqet ta ndërtojë LDK-ja? Analistët thonë se dëmi më i madh nuk vjen nga koalicioni lokal




PRISHTINË, 8 MAJ - "Bashkimi i së djathtës" në Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), i paralajmëruar si synim i kësaj partie deri tash opozitare, po sfidohet në prag të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, të cilat do të mbahen më 7 qershor.
Përderisa udhëheqësit e LDK-së po i finalizojnë bisedimet për një listë të përbashkët zgjedhore me ish-presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, në Prishtinë - ku pushtetin lokal e drejton kjo parti - këtë javë u shfaqën mosmarrëveshje të brendshme.
Përparim Rama, i cili në zgjedhjet lokale të tetorit të vitit të kaluar u rikonfirmua në krye të Komunës së Prishtinës nën logon e LDK-së, gjatë kësaj jave lidhi marrëveshje për koalicion të qeverisjes lokale me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK).
Pasuan largimet e drejtuesve të disa drejtorive komunale nga radhët e LDK-së, në vend të të cilëve u vendosën ata të PDK-së.
Reagimi i LDK-së, e cila Prishtinën e konsideron si bastion të saj elektoral, ishte i menjëhershëm përmes një komunikate për opinion: partia e drejtuar nga Lumir Abdixhiku tha se strukturat e saj nuk kanë qenë pjesë e kësaj marrëveshjeje, dhe se ajo "nuk krijon obligime politike për LDK-në".

## A ka përplasje brenda LDK-së?

Rreth asaj se çfarë po ndodh në LDK e kemi pyetur nënkryetarin e partisë, Lutfi Haziri. Ja çfarë tha ai për Radion Evropa e Lirë (REL): "Është një lloj moskoordinimi, një lloj tensionimi, por besoj që do të përballohet".
Ai shtoi se, megjithatë, vendimi i Ramës për koalicion me PDK-në për qeverisje lokale "e ka prekur" nismën për bashkimin e së djathtës brenda LDK-së dhe të forcimit të saj para zgjedhjeve të parakohshme. "Ia ka humbur shkëlqimin këtij procesi. Kështu do ta definoja, jo më tepër...", u shpreh ai, duke shtuar se "për momentin, kjo është e tejkalueshme".
Rama, ndërkaq, përmes një postimi në Facebook, u shpreh "kundër çdo retorike përçarëse", dhe e arsyetoi marrëveshjen me PDK-në si diçka të mirë në interes të qytetarëve, duke thënë se "qytetarët nuk jetojnë në parti".

## Si shihen këto zhvillime?

Politologu Dritëro Arifi konsideron se pretendimi i LDK-së për një bashkim të së djathtës në prag të zgjedhjeve të majit është ambicie me mjaft sfida, por jo e parealizueshme.
Sipas tij, praktikat e deritashme kanë treguar se partitë kundërshtare lidhin koalicione për bashkëqeverisje lokale në komuna të ndryshme.
Në këtë drejtim, ai konsideron se koalicioni i Ramës me PDK-në në kryeqytet nuk e dëmton më shumë LDK-në sesa shpërfaqja e mosmarrëveshjeve në publik. "Kjo po e shpërfaq një tjetër anë negative të LDK-së - nuk ka koordinim të duhur... Nëse nuk arrijnë ta menaxhojnë më mirë [situatën] dhe e përshkallëzojnë situatën me këto deklarata të palogjikshme, atëherë dëmtohet më shumë lideri i partisë. Ia humb një lloj kredibiliteti, panevojshëm", tha Arifi për REL-in.
Ai shtoi se mosmarrëveshjet brenda LDK-së reflektohen edhe në komunikatën e saj lidhur me vendimin e Ramës. "Kjo e dëmton partinë edhe në nivel qendror, sepse po vërehet se partia nuk e ka kontrollin edhe mbi degët e veta", tha Arifi.
Në sytë e analistit Ylli Hoxha, LDK-ja aktualisht është gjetur përballë interesave të saj për zgjedhjet në nivel qendror dhe interesave të Ramës për krijimin e një shumice për qeverisje bashkë me PDK-në në nivel lokal në Prishtinë.
Por, ai pret që udhëheqësit e LDK-së dhe Rama të jenë të kujdesshëm për të ruajtur një minimum të unitetit në parti, para zgjedhjeve parlamentare. "Do të ishte krejtësisht e papërgjegjshme që ta kthesh Vjosa Osmanin, dhe të pretendosh ta bashkosh të djathtën, ndërkaq ta humbësh kryetarin e komunës [së Prishtinës]. Besoj që do të ketë proces, i cili do ta parandalojë përshkallëzimin e mëtutjeshëm të kësaj krize", tha Hoxha për REL-in.

## Efekti në rezultatin e zgjedhjeve parlamentare

LDK-ja e sheh si të menaxhueshme situatën e krijuar nga, siç e kanë quajtur në parti, "moskordinimi" me Ramën, dhe nuk pret që kjo situatë të ndikojë negativisht në rezultatin e partisë në zgjedhjet e 7 qershorit. Rama ka thënë se ashtu siç e ka "përkrahur pakusht LDK-në në zgjedhjet e kaluara, do ta përkrah edhe në këto zgjedhje".
As politologu Arifi nuk pret që mosmarrëveshja e shpërfaqur ndërmjet LDK-së dhe Ramës të ndikojë në rezultatin zgjedhor të kësaj partie. "Nëse dinë ta menaxhojnë këtë çështje, po besoj që do të dalin pa u dëmtuar, dhe pa u vërejtur fare që ka pasur ndonjë jokomunikim ose keqkuptime të këtyre dy niveleve", tha Arifi.
Edhe analisti Hoxha mendon që LDK-ja do të arrijë ta menaxhojë situatën. Në të kundërtën, sipas tij, përshkallëzimi eventual i përplasjes ndërmjet udhëheqjes së LDK-së dhe kryetarit të Prishtinës do të ndikonte negativisht në rezultatin zgjedhor të partisë. "Konsideroj se të gjithë këta aktorë kanë një pjekuri minimale se [një situatë konflikti] do të bëjë dëm", tha Hoxha.
Ai dhe Arifi besojnë se një stabilitet brenda LDK-së do të ndikojë në një rezultat zgjedhor më të mirë të kësaj partie, krahasuar me zgjedhjet e dhjetorit të vitit të kaluar.
Në ato zgjedhje, LDK-ja doli si partia e tretë më e votuar, me 13.57 për qind të votave të fituara, që i siguroi 15 vende në Kuvendin e Kosovës.
Me minus 52 mijë vota në krahasim me zgjedhjet e shkurtit të vitit 2025, LDK ngeli me 5 vende më pak në Kuvend.



PËRMBYLLET AFATI PËR PARTITË POLITIKE PËR PJESËMARRJE NË ZGJEDHJE DHE PËR DEKLARIMIN E KOALICIONEVE PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 7 QERSHORIT

# 22 PARTI E TRI KOALICIONE DO TË GAROJNË NË ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se më 7 maj është përmbyllur afati për partitë politike të regjistruara në Kosovë për pjesëmarrje ose mospjesëmarrje në zgjedhje dhe formim të koalicioneve. Gjatë periudhës 7-ditore, KQZ-ja ka pranuar njoftimin për pjesëmarrje në zgjedhje nga 22 parti politike, mospjesëmarrje nga 9 parti politike dhe 3 koalicione. Këto do të jenë zgjedhjet e treta parlamentare brenda 18 muajsh, pas atyre në shkurt dhe dhjetor 2025

EPOKA E RE Mal QORRAJ

**Prishtinë, 8 maj** - Njëzet e dy parti politike dhe tri koalicione do të garojnë zyrtarisht në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit, ndërkaq Nisma Socialdemokrate e Fatmir Limajt nuk do të marrë pjesë, ka konfirmuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të premten.

Partitë dhe koalicionet kishin kohë deri në mesnatën e së enjtes për t'u regjistruar për pjesëmarrje në zgjedhjet e muajit të ardhshëm, të cilat vijnë si pasojë e shpërndarjes së Kuvendit nga dështimit për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit.

Partia në pushtet e kryeministrit në detyrë të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit, do të garojë sërish në një koalicion me partitë Guxo, Alternativa dhe Partia Shqiptare Demokristiane.

Pjesë e garës do të jetë edhe ish-presidentja Vjosa Osmani, e cila pritet të garojë në një listë me ish-partinë e vet, Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK).

Po ashtu, do të garojë edhe Partia Socialdemokrate (PSD) e përbërë kryesisht nga anëtarë të dikurshëm të partisë në pushtet Lëvizja Vetëvendosje.

Partitë politike që kanë njoftuar pjesëmarrjen në zgjedhje janë: 1. Partia Socialdemokrate; 2. Kosovaki Nevi Romani Partia; 3. Partia Socialdemokrate e Ashkalinjve; 4. Za Slobodu Pravdu i Opstanak; 5. Srpska Lista; 6. Yenilikçi Türk Hareket Partisi; 7. Lidhja Demokratike e Kosovës; 8. Fjala; 9. Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës; 10. Partia Rome e Bashkuar e Kosovës - PREBK; 11. Socialdemokratska Unija; 12. Jedinstvena Goranska Partija; 13. Kosova Demokratik Türk Partisi; 14. Nova Demokratska Stranka; 15. Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës; 16. Kosovski Savez; 17. Partia Balliste; 18. Partia Qytetare për Mirëqenie Sociale; 19. Partia Liberale Egjiptiane; 20. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës; 21. Stranka Demokratske Akcije; dhe 22. Partia Demokratike e Kosovës.

Partitë politike që kanë njoftuar për formim të koalicionit janë: 1. Demokratska Stranka Bošnjaka dhe Demokratska Stranka Vatan (Koalicija VAKAT); (2). Partia e Ashkalinjëve për Integrim, Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës dhe Lëvizja për Bashkëveprim (Ashkalitë e Bashkuar) dhe 3. Lëvizja Vetëvendosje, Guxo, Alternativa dhe Partia Shqiptare Demokristiane (Lëvizja Vetëvendosje!).

"Partitë politike që kanë njoftuar mospjesëmarrjen në zgjedhje janë: 1. Partia Demokratike e Unitetit; 2. Balli Kombëtar i Kosovës; 3. Lëvizja Qytetare Vatra; 4. Bashkimi për Ndryshim Anamorava; 5. Partia e Drejtësisë; 6. Srpski Narodni Pokret; 7. Partia Reforma Demokratike; 8. Aleanca Kosova e Re; dhe 9. Nisma Socialdemokrate", ka njoftuar KQZ-ja.

Nisma Socialdemokrate, ka dështuar ta kalojë pragun në zgjedhjet e kaluara në dhjetor, vendosi të mos garojë e vetme.

Në zgjedhjet paraprake, Nisma kishe hyrë në Kuvend pasi kishte garuar në një koalicion me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Thuhej se Limaj kishte bërë përpjekje për të bashkëpunuar me partinë më të madhe opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për të garuar në një listë të përbashkët.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka deklaruar në TV Dukagjini se partia e tij nuk do të marrë pjesë në zgjedhje nëse nuk bashkohet me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) në një listë.

Ai ka thënë se Nisma, sipas tij, tashmë është përgatitur për një opozitë jashtë parlamentit. "Para tre muajsh jemi përgatitur për një opozitë jashtë parlamentit, për katër vjet opozitë. Ky që po ndodh është një lloj rivotimi nga zgjedhjet e fundit. Po përgatitemi për raundin tjetër zgjedhor", ka deklaruar ai.

Subjektet politike dhe koalicionet kanë kohë deri më 12 maj për t'i dorëzuar online listën me emrat e kandidatëve për deputetë për certifikim të pjesëmarrjes në këto zgjedhje.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë do të mbahen më 7 qershor pasi vendi dështoi ta zgjedhë një president të ri për t'i shmangur ato. "KQZ-ja njofton se janë duke vazhduar afatet për aplikimin e subjekteve politike për certifikim dhe dorëzimin e listës së kandidatëve për deputetë për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të cilat do të mbahen më 7 qershor 2026. Proceset e aplikimit për certifikim dhe dorëzimit të listave të kandidatëve do të zhvillohen në mënyrë elektronike, përmes platformës së KQZ-së, respektivisht përmes Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP)", ka njoftuar KQZ-ja.

Këto do të jenë zgjedhjet e treta parlamentare brenda 18 muajsh, pas atyre në shkurt dhe dhjetor 2025.

## LV, Guxo, Alternativa dhe PSHDK nënshkruajnë marrëveshje koalicion

Lëvizja Vetëvendosje!, Partia Guxo, Partia Alternativa dhe Partia Shqiptare Demokristiane kanë arritur marrëveshje koalicioni, duke riafirmuar përkushtimin e tyre për vazhdimin e bashkëpunimit politik dhe institucional në shërbim të qytetarëve dhe interesit publik. "Kjo marrëveshje bazohet mbi vlerat e demokracisë, transparencës, sundimit të ligjit, zhvillimit ekonomik, drejtësisë sociale dhe forcimit të shtetit të Kosovës. Partnerët e koalicionit janë zotuar të punojnë ngushtë për ruajtjen e sovranitetit, integritetit territorial dhe avancimin e reformave që fuqizojnë institucionet demokratike dhe mirëqenien qytetare. Kjo marrëveshje përfaqëson një angazhim të përbashkët për qeverisje të përgjegjshme, demokratike dhe në funksion të interesit qytetar", ka njoftuar Lëvizja Vetëvendosje.

# LIMAJ I ÇON LETËR HAMZËS, KËRKON QË NISMA TË JETË PJESË E LISTËS SË PDK-së PËR ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT



**Prishtinë, 8 maj** - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, i ka dërguar letër kreut të PDK-së, Bedri Hamza, që partia e tij të jetë pjesë e listës së kësaj partie, për të garuar në zgjedhjet e 7 qershorit.

Limaj ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim dhe bashkim politik, në "funksion të krijimit të një alternative të fuqishme dhe përfaqësuese për qytetarët e Republikës së Kosovës". "Në frymën e përgjegjësisë politike dhe shtetërore, si dhe duke respektuar kërkesën dhe pritjen e vazhdueshme të shumë qytetarëve, mbështetësve dhe strukturave tona për bashkimin e potencialit politik që përfaqësojnë PDK-ja dhe NISMA Socialdemokrate, përmes kësaj shkrese ju paraqesim zyrtarisht gatishmërinë tonë për pjesëmarrje në listën zgjedhore të PDK-së për zgjedhjet e 7 qershorit. NISMA Socialdemokrate dhe unë, si kryetar i saj, kemi shprehur vazhdimisht, si para këtyre zgjedhjeve ashtu edhe në vazhdimësi, gatishmërinë për bashkëpunim dhe bashkim politik në funksion të krijimit të një alternative të fuqishme dhe përfaqësuese për qytetarët e Republikës së Kosovës", është thënë në letrën e Limajt, dërguar Hamzës.



NISMA SOCIALDEMOKRATE

NISMA Socialdemokrate

Prishtinë,07.05.2026

Ref. 16/2026

I nderuari z. Bedri HAMZA, Kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës,

Të nderuar anëtarë të Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës,

Në frymën e përgjegjësisë politike dhe shtetërore, si dhe duke respektuar kërkesën dhe pritjen e vazhdueshme të shumë qytetarëve, mbështetësve dhe strukturave tona për bashkimin e potencialit politik që përfaqësojnë PDK-ja dhe NISMA Socialdemokrate, përmes kësaj shkrese ju paraqesim zyrtarisht gatishmërinë tonë për pjesëmarrje në listën zgjedhore të PDK-së për zgjedhjet e 7 qershorit.

NISMA Socialdemokrate dhe unë, si kryetar i saj, kemi shprehur vazhdimisht, si para këtyre zgjedhjeve ashtu edhe në vazhdimësi, gatishmërinë për bashkëpunim dhe bashkim politik në funksion të krijimit të një alternative të fuqishme dhe përfaqësuese për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ne besojmë se një bashkim i tillë nuk përfaqëson vetëm një marrëveshje politike apo elektorale, por edhe një frymë të bashkëpunimit ndërmjet njerëzve dhe strukturave që për vite të tëra kanë ndarë ideale, sakrificë dhe vizion të përbashkët për Kosovën.

Në këtë frymë, dëshirojmë të theksojmë se angazhimi ynë nuk udhëhiqet nga kërkesa të veçanta politike apo organizative, por nga bindja se bashkimi dhe koordinimi i potencialit opozitar është në interes të Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Njëkohësisht, shprehim gatishmërinë tonë për të dhënë kontributin e plotë politik, organizativ dhe elektoral në kuadër të këtij procesi të përbashkët.

Duke besuar në mirëkuptimin, respektin reciprok dhe vullnetin për bashkëpunim, mbetemi të gatshëm për koordinimet dhe hapat e mëtejmë lidhur me këtë proces.

Me respekt,

Fatmir LIMAJ
Kryetar
NISMA Socialdemokrate

Limaj ka thënë se bashkimi me PDK-në nuk përfaqëson vetëm një marrëveshje politike apo elektorale, por një frymë të bashkëpunimit ndërmjet njerëzve dhe strukturave që për vite të tëra kanë ndarë ideale, sakrificë dhe vizion të përbashkët për Kosovën. "Ne besojmë se një bashkim i tillë nuk përfaqëson vetëm një marrëveshje politike apo elektorale, por edhe një frymë të bashkëpunimit ndërmjet njerëzve dhe strukturave që për vite të tëra kanë ndarë ideale, sakrificë dhe vizion të përbashkët për Kosovën. Në këtë frymë, dëshirojmë të theksojmë se angazhimi ynë nuk udhëhiqet nga kërkesa të veçanta politike apo organizative, por nga bindja se bashkimi dhe koordinimi i potencialit opozitar është në interes të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Njëkohësisht, shprehim gatishmërinë tonë për të dhënë kontributin e plotë politik, organizativ dhe elektoral në kuadër të këtij procesi të përbashkët. Duke besuar në mirëkuptimin, respektin reciprok dhe vullnetin për bashkëpunim, mbetemi të gatshëm për koordinimet dhe hapat e mëtejmë lidhur me këtë proces",

Kujtojmë se Nisma e Fatmir Limaj ka njoftuar KQZ-në se nuk do të merr pjesë në zgjedhjet e 7 qershorit.

## Haxhiu dekreton një sërë ligjesh të rëndësishme për qytetarët dhe shtetin

**Prishtinë, 8 maj** - U.d. presidentja e Kosovës, Albulena Haxhiu, ka njoftuar se ka dekretuar shpalljen e një sërë ligjesh që, sipas saj, kanë rëndësi të veçantë për qytetarët dhe për forcimin e Republikës së Kosovës.

Përmes një postimi publik, ajo bëri të ditur se disa nga ligjet e dekretuara lidhen drejtpërdrejt me jetën e përditshme të qytetarëve, përfshirë banimin social dhe të përballueshëm, kujdesin shëndetësor, shtetësinë, shërbimet e pagesave, resurset ujore dhe maturën shtetërore.

Haxhiu po ashtu theksoi se ka dekretuar edhe ligjin për ratifikimin e marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Bordin e Paqes, ligjin për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030, si dhe ligje që lidhen me marrëveshje financiare me Bashkimi Evropian dhe Agjencinë Franceze për Zhvillim. "Kam dekretuar shpalljen e një sërë ligjesh të rëndësishme për qytetarët dhe për Republikën. Disa prej tyre lidhen drejtpërdrejt me jetën e përditshme, me banimin social dhe të përballueshëm, kujdesin shëndetësor, shtetësinë, shërbimet e pagesave, resurset ujore dhe maturën shtetërore. Po ashtu, kam dekretuar ligjin për ratifikimin e marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Bordin e Paqes, ligjin për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030, si dhe ligjet që lidhen me marrëveshjet financiare me Bashkimin Evropian dhe Agjencinë Franceze për Zhvillim. Ligjet marrin peshë kur shndërrohen në shërbim për qytetarin dhe në forcim të Republikës", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".



## Kryeprokurori Isufaj pret në takim personalitete të njohura amerikane dhe ndërkombëtare nga fusha e drejtësisë



**Prishtinë, 8 maj** - Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj, ka zhvilluar një takim me personalitete të njohura amerikane dhe ndërkombëtare nga fusha e drejtësisë, sundimit të ligjit dhe luftimit të trafikimit me qenie njerëzore, në kuadër të vizitës së tyre në Republikën e Kosovës.
Në takim kanë marrë pjesë Todd Hendricks, njëri nga organizatoret e Lutjeve të Mëngjesit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe mbështetës i kahershëm i Kosovës dhe John Cotton Richmond, një nga ekspertët më të njohur amerikanë në fushën e luftimit të trafikimit me qenie njerëzore dhe krimit ndërkombëtar.
Gjatë takimit është diskutuar për rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në forcimin e sundimit të ligjit, luftimin e krimit të organizuar dhe trafikimit me qenie njerëzore, si dhe për avancimin e kapaciteteve profesionale dhe shkëmbimin e praktikave më të mira ndërmjet institucioneve të drejtësisë dhe partnerëve ndërkombëtarë.
Kryeprokurori Isufaj ka falënderuar mysafirët për vizitën dhe për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Republikës së Kosovës, duke theksuar përkushtimin institucional për forcimin e sundimit të ligjit dhe bashkëpunimit me partnerët strategjikë ndërkombëtarë.
Nga ana e tyre, mysafirët kanë vlerësuar progresin institucional të Kosovës në fushën e drejtësisë dhe ritheksuan gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit profesional dhe institucional në iniciativa që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe avancimin e sigurisë dhe drejtësisë ndërkombëtare.

# ANTONOV NË KOSOVË: KREJT ÇFARË DIHET PËR FLUTURIMIN E AVIONIT TË MADH TRANSPORTUES




**Prishtinë, 8 maj** - Mbërritja e një avioni të tipit Antonov An-124 në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", më 6 maj, nxiti kureshtjen e shumëkujt në Kosovë.
Por, arsyeja e fluturimit drejt Kosovës të njërit prej aeroplanëve më të mëdhenj në botë për transportin e mallrave, përfshirë ato ushtarake, mbetet ende e panjohur.
Radio Evropa e Lirë (REL) ka kërkuar të enjten informacione nga Aeroporti i Prishtinës në lidhje me ardhjen e fluturakes së madhe të prodhimit ukrainas, por nuk ka marrë përgjigje.
Fluturimi i aeroplanit me regjistrimin UR-82008 nuk ka figuruar as në regjistrat e fluturimeve komerciale online.
Ministria e Mbrojtjes në Kosovë ka thënë se nuk ka informacione zyrtare lidhur me këtë fluturim.
Fotografi i njohur kosovar, Arian Mavriqi, e ka fotografuar dhe e ka xhiruar uljen e djeshme të aeroplanit gjigant, i cili në Kosovë është parë edhe në të kaluarën.
Edhe entuziastë të aviacionit, vendës e të huaj, po ashtu kanë publikuar fotografi e video të uljes së Antonov An-124 në aeroportin që ndodhet 17 kilometra larg kryeqytetit kosovar, duke aluduar se aeroplani është nisur nga një bazë ajrore në Gjermani.
Sipas tyre, ai mund të ketë sjellë pajisje ushtarake për misionin paqeruajtës të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë - KFOR.
Por, nga ky mision i NATO-s nuk iu përgjigjën pyetjeve të REL-it në lidhje me këtë çështje.
Ndërkaq, Ministria e Mbrojtjes e Gjermanisë i tha REL-it se, "si çështje parimore dhe pavarësisht nga pyetja specifike, nuk komenton transportet ushtarake", si dhe që përgjigja e saj nuk përbën as konfirmim e as mohim në lidhje me këtë fluturim.
Ajo, megjithatë, tha se forcat e armatosura gjermane përdorin shërbimin e transportit të kompanisë Antonov.
"…Kapacitetet e Antonov Logistics SALIS GmbH [përdoren] për dërgimin dhe furnizimin e forcave gjermane në kontekstin e mbrojtjes kombëtare dhe mbrojtjes së aleancës, menaxhimit të krizave ndërkombëtare dhe menaxhimit të rreziqeve dhe krizave kombëtare", i tha REL-it një zëdhënës i Ministrisë gjermane të Mbrojtjes.

### Për çfarë përdoren aeroplanët Antonov?

Sipas të dhënave zyrtare, të publikuara nga vetë kompania ajrore, Antonov Airlines është një degë e Antonov Company, me seli në Kiev, Ukrainë.
Ndërmarrja shtetërore ukrainase operon një flotë të gjerë avionësh që transportojnë mallra, duke përfshirë pesë avionë të tipit An-124 Ruslan, që mund të bartin ngarkesa deri në 150 tonë.
Dy prej këtyre aeroplanëve përdoren zyrtarisht përmes kompanisë Antonov Logistic SALIS GmbH, për të ofruar shërbime transportuese për NATO-n dhe vendet e Bashkimit Evropian për dërgimin e "mallrave emergjente në situata të krizës".
Sipas informacioneve në ueb-sajtin e kompanisë, shërbimet përgjegjëse për planifikimin e transportit dhe mirëmbajtjes së avionëve janë zhvendosur përkohësisht në Lajpcig të Gjermanisë, për shkak të luftës në Ukrainë.

### Fluturimet e mëparshme në Kosovë

Aeroplani i kompanisë Antonov nuk erdhi për herë të parë në Kosovë të mërkurën.
Vetë Aeroporti i Prishtinës kishte publikuar fotografi të këtij aeroplani, kur ai kishte mbërritur në Kosovë më 2016.
Ndërkaq, grupi BBKRspotters, i cili publikon pamje të fluturimeve në Aeroportin e Prishtinës, kishte publikuar një video të uljes së këtij aeroplani në "Adem Jashari" në janarin e vitit 2024.
Radio Evropa e Lirë ka kërkuar informacione nga vetë kompania e fluturimeve Antonov për fluturimin e djeshëm, por deri në momentin e publikimit të këtij teksti nuk ka marrë përgjigje.

## Shqipe Selimi nga Haga: Nuk ka shtyrje e as vonesë që na lodhë




**Hagë, 8 maj** - Ish-deputetja e LV-së, Shqipe Mehmeti Selimi ka qëndruar në Hagë pasi ka vizituar bashkëshortin e saj, Rexhep Selimi, i cili po përballet me proces gjyqësor në Dhomat e Specializuara.
Selimi këtë e bëri me dije një postimi në rrjetin social në "Facebook" se "Nuk ka shtyrje e as vonesë që na lodhë! Krenarë".
Gjykata Speciale ka shtyrë shpalljen e aktgjykimit për rastin ndaj ish-krerëve të UÇK-së deri më 20 korrik.

## Inspektorati i Punës ndalon 126 punime në sektorët me rrezikshmëri




PRISHTINË, 8 MAJ - Inspektorati Qendror i Punës, në zbatim të vendimit të ministrit të Ministrisë së Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare (MPFVLÇ) dhe në përputhje me mandatin e tij ligjor, ka njoftuar se ndërmarrë aksion të jashtëzakonshëm inspektues në sektorët me rrezikshmëri të lartë, në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, ku ka ndaluar 126 punime.
Inspektorati Qendror i Punës ka thënë se raporti i prezantuar paraqet rezultatet përmbledhëse të inspektimeve, të realizuara në kuadër të këtij aksioni.
Në përfundim të aksionit, të gjitha subjektet ndaj të cilave është shqiptuar masa e ndalimit të punimeve, procesohen automatikisht në Gjykatën për Kundërvajtje, përkatësisht për shkeljet e konstatuara. "Procesi i riinspektimeve do të zhvillohet në ditët në vijim të aksionit, sipas afateve kohore të përcaktuara nga inspektorët për eliminimin e parregullsive. Eliminimi i parregullsive nënkupton procesin kur subjekti i inspektuar ka ndërmarrë veprime për përmirësimin e gjendjes së SSHP-së. Rastet e proceduara në polici nënkuptojnë rastet kur punëkryerësit/investitorët kanë vazhduar punimet në kantier në kundërshtim me vendimin e inspektorëve për ndalim të punimeve, si dhe dëmtimin e shiritit ndalues. Rastet e paraqitura në polici nuk barazohen numerikisht në tabelë, pasi ato janë raste ndaj punëdhënësve/investitorëve që kanë në fuqi vendimin për ndalim të punimeve", ka njoftuar MPFVLÇ-ja.

# KUSARI-LILA: QYTETARËT E KOSOVËS NDËR POPUJT MË PRO-EVROPIANË NË BALLKAN

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 MAJ - Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka marrë pjesë në panelin përmbyllës të "St. Gallen Symposium 2026" në Zvicër, me temën "Fuqia e politikës përballë politikës së fuqisë - Ruajtja e interesave strategjike në një botë të re".
Në panel, ministrja Kusari-Lila ka diskutuar së bashku me Kelly Craft, ish-ambasadore e SHBA-së në Kombet e Bashkuara, Kęstutis Budrys, ministër i Punëve të Jashtme i Lituanisë, dhe Emma Theofelus, ministre e Informacionit, Komunikimit dhe Teknologjisë e Namibisë, në një debat të moderuar nga Michael Brocker.
Sipas Kusari-Lilës, diskutimi është fokusuar në ndryshimet e rendit global, rritjen e multipolaritetit dhe ndikimin e politikave të fuqive të mëdha në një kohë kur multilateralizmi po përballet me dobësim të vazhdueshëm.
Ajo ka theksuar se në debat është trajtuar edhe roli i mekanizmave ndërkombëtarë në ruajtjen e paqes dhe parandalimin e konflikteve, si dhe ndikimi i ndryshimeve gjeopolitike në funksionimin e tyre.
Ministrja Kusari-Lila ka deklaruar se, pavarësisht ngecjeve në procesin e integrimit evropian, qytetarët e Kosovës vazhdojnë të mbeten ndër popujt më pro-evropianë në Ballkan.
Ajo ka ritheksuar se rruga drejt Bashkimit Evropian mbetet alternativa e vetme strategjike për Kosovën.




Gjatë diskutimit, ajo ka ngritur shqetësimin për standardet e dyfishta ndaj shteteve të vogla, duke përmendur Kosovën në raport me dialogun me Serbinë dhe mungesën e pasojave për aktet terroriste ndaj Kosovës.
Sipas saj, praktika të tilla rrezikojnë të dëmtojnë besimin e qytetarëve ndaj rendit ndërkombëtar dhe institucioneve që duhet ta mbrojnë atë.
Kusari-Lila ka theksuar gjithashtu se Bashkimi Evropian nuk duhet ta konsiderojë Ballkanin Perëndimor si kufi të jashtëm, por si pjesë të natyrshme të projektit evropian.
Në panel janë trajtuar edhe zhvillimet globale të sigurisë, përfshirë konfliktin me Iranin, ekspozimin e vendeve baltike ndaj kërcënimeve nga Rusia, si dhe sfidat dhe krizat në kontinentin afrikan.

# ZËVENDËSMINISTRI LLESHI VIZITËN E PARË ZYRTARE NË SHQIPËRI, RIKONFIRMOHET PARTNERITETI STRATEGJIK



TIRANË, 8 MAJ - Zëvendësministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, Gegë Lleshi, realizoi vizitën e parë zyrtare në Republikën e Shqipërisë, ku zhvilloi takime me ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe drejtues të tjerë të lartë institucionalë e ushtarakë.
Gjatë vizitës, zëvendësministri Lleshi u prit nga ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Ermal Nufi, me të cilin diskutoi mbi forcimin e bashkëpunimit bilateral në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, avancimin e projekteve të përbashkëta dhe koordinimin përballë sfidave të sigurisë.
Delegacioni zhvilloi takim edhe me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, Arben Kingji, ku u diskutua për rritjen e ndërveprueshmërisë dhe avancimin e bashkëpunimit ushtarak sipas standardeve të NATO-s.
Në kuadër të vizitës u realizuan takime edhe me drejtues të strukturave të inteligjencës ushtarake, përfaqësues të Komandës Kibernetike dhe institucioneve ushtarake arsimore në Republikën e Shqipërisë.
Zëvendësministri Lleshi takoi gjithashtu kadetë dhe studentë të Forcës së Sigurisë së Kosovës që po ndjekin shkollimin në akademitë ushtarake shqiptare, duke i inkurajuar për profesionalizëm dhe përkushtim në shërbim të vendit.
Vizita rikonfirmoi marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe përkushtimin e përbashkët për forcimin e bashkëpunimit strategjik në funksion të paqes dhe sigurisë rajonale.

## QKUK-ja realizon me sukses një ndërhyrje komplekse tek një 71-vjeçare



PRISHTINË, 8 MAJ - Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka bërë me dije se në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare është realizuar me sukses një ndërhyrje komplekse kirurgjikale për trajtimin e aneurizmës së arteries splenike tek një paciente 71-vjeçare. Aneurizma, me dimension rreth 7 cm dhe pjesërisht e trombozuar, paraqiste rrezik të lartë për rupturë dhe gjakderdhje potencialisht fatale.
Pas diagnostikimit me angiografi CT (CTA), ekipi multidisiplinar vendosi për trajtim kirurgjikal të hapur. Gjatë ndërhyrjes është kryer aneurizmektomia dhe rekonstruksioni vaskular me anastomozë termino-terminale të arteries splenike, duke bërë të mundur ruajtjen e splenit dhe funksionit të tij imunologjik e hematologjik.
Rasti është shoqëruar edhe me sfida të rëndësishme anesteziologjike dhe pulmonare, të cilat janë menaxhuar me sukses nga ekipi profesional i anesteziologjisë dhe kujdesit intensiv. Pacientja ka qëndruar për monitorim intensiv postoperativ për 48 orë dhe është liruar nga klinika pas 7 ditësh në gjendje të mirë shëndetësore.
Në njoftimin për media është thënë se ky sukses pasqyron profesionalizmin, përkushtimin dhe bashkëpunimin multidisiplinar të stafit të QKUK-së në trajtimin e rasteve komplekse kirurgjikale dhe ofrimin e kujdesit cilësor për pacientët.

## OEK-u pjesë e simpoziumit ndërkombëtar për arbitrazhin dhe zgjidhjen alternative të kontesteve

PRISHTINË, 8 MAJ - Oda Ekonomike e Kosovës, nën udhëheqjen e dr. prof. Vjollca Visoka Hasani, kryetare e Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Kosovës, po merr pjesë në një simpozium të rëndësishëm ndërkombëtar të organizuar në kuadër të Programit për Zhvillimin e së Drejtës Komerciale - Departamenti i Tregtisë i SHBA-së, për Programet e Zgjidhjes Alternative të Kontesteve - Global Resolution Symposium.
Në këtë aktivitet po marrin pjesë ekspertë dhe profesionistë të njohur ndërkombëtarë në fushën e arbitrazhit dhe zgjidhjes alternative të kontesteve, duke krijuar një platformë të rëndësishme për shkëmbim përvojash dhe avancim të praktikave profesionale.
Oda Ekonomike e Kosovës e ka vendosur reformimin e arbitrazhit si një nga objektivat strategjike, me synim krijimin e mekanizmave më efikasë për zgjidhjen e shpejtë të kontesteve afariste.
Ky reformim pritet të jetë në funksion të mbështetjes së bizneseve dhe palëve të tjera, duke mundësuar procedura më të shpejta dhe më efikase, si dhe duke kontribuar në lehtësimin e ngarkesës së sistemit gjyqësor përmes zgjidhjes së rasteve në arbitrazh.



# BQK, ATK, NJIF-K DHE IQMT FORCOJNË KOORDINIMIN PËR INTEGRITETIN E SISTEMIT FINANCIAR

PRISHTINË, 8 MAJ - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, i shoqëruar nga zëvendësguvernatori Milot Cakaj dhe bashkëpunëtorë të BQK-së, priti në takim drejtorin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Mentor Hyseni, drejtorin e Njësisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës (NJIF-K), Genc Rraci, si dhe u.d. kryeinspektorin e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut (IQMT), Florent Kuçi.



Takimi u fokusua në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për zhvillimet në sektorin financiar, me theks të veçantë në ruajtjen e integritetit të sektorit financiar, pajtueshmërinë me legjislacionin në fuqi, me theks të aktivitetet që kërkojnë vëmendjen institucionale dhe promovimin e konkurrencës së drejtë në treg.
Gjatë takimit u diskutua për zhvillimet aktuale në sektorin financiar dhe biznesor, avancimin e koordinimit ndërinstitucional, shkëmbimin e informacionit brenda kornizave ligjore, si dhe forcimin e bashkëpunimit në mbështetje të zbatimit efektiv të mandateve dhe përgjegjësive të secilit institucion.
Në këtë kontekst, u vlerësua rëndësia e një qasjeje të koordinuar institucionale për adresimin e rreziqeve potenciale, forcimin e mbikëqyrjes dhe mbështetjen e stabilitetit financiar, sundimit të ligjit dhe funksionimit të rregullt të tregut.
Një pjesë e veçantë e diskutimit iu kushtua zbatimit të Ligjit për Kripto-Asetet dhe rregulloreve të BQK-së për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të lidhura me kripto-asetet.
Palët diskutuan veprimet institucionale lidhur me veprimtarinë e subjekteve financiare në këtë fushë, rëndësinë e pajtueshmërisë me kërkesat ligjore dhe rregullative, si dhe nevojën për sigurimin që vetëm aktivitetet e licencuara operojnë ashtu që të mos cenojnë integritetin financiar, mbrojtjen e konsumatorëve dhe konkurrencën e drejtë.
Drejtuesit e institucioneve vlerësuan se bashkëpunimi i ngushtë ndërinstitucional, në përputhje me mandatet e pavarura dhe kompetencat përkatëse ligjore, është thelbësor për zbatimin efektiv të legjislacionit, mbrojtjen e integritetit të sektorit financiar dhe forcimin e besimit në treg.
Po ashtu, u ritheksua rëndësia e koordinimit të vazhdueshëm për mbikëqyrjen e aktiviteteve financiare dhe biznesore, si dhe për garantimin e një mjedisi të rregulluar, transparent dhe konkurrues.
Në takim u dakordua që institucionet të vazhdojnë komunikimin dhe bashkëpunimin profesional, përfshirë shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e veprimeve brenda kornizës ligjore, me qëllim të mbështetjes së stabilitetit financiar, integritetit të tregut dhe zbatimit të plotë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

# RRITET NUMRI I NDËRMARRJEVE TË REGJISTRUARA

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 MAJ - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar repertorin statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë për muajin mars 2026.
Në muajin mars 2026 gjithsej janë regjistruar 1 339 ndërmarrje, ku krahasuar me muajin paraprak ka rritje të ndërmarrjeve të regjistruara për 13,9 %.
Ndërsa krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (Mars 2025), numri i ndërmarrjeve të regjistruara është rritur për 29,0 %.
Aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij muaji ishin: Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 356 ndërmarrje të regjistruara (26,6 %); Ndërtimtaria me 147 ndërmarrje të regjistruara (11,0%); Prodhimi me 133 ndërmarrje të regjistruara (9,9 %); Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimeve me ushqim me 124 ndërmarrje të regjistruara (9,3%), etj.



Në kategorinë "Mikro Ndërmarrje" (0 deri në 9 të punësuar) janë regjistruar gjithsej 1 328 ndërmarrje; në kategorinë "Ndërmarrje të Vogla" (10 deri 49 të punësuar) janë regjistruar gjithsej 11 ndërmarrje; në kategorinë "Ndërmarrje të Mesme" (50 deri 249 të punësuar) dhe në kategorinë "Ndërmarrje të Mëdha" (250+), nuk ka ndërmarrje të regjistruara këtë muaj.
Shtrirja gjeografike e ndërmarrjeve të regjistruara në nivel rajoni është: Rajoni i Prishtinës prin me 605 ndërmarrje të regjistruara (45,2 %); Rajoni i Ferizajt me 173 ndërmarrje të regjistruara (12,9 %); Rajoni i Pejës me 136 ndërmarrje të regjistruara (10,2%); Rajoni i Mitrovicës me 122 ndërmarrje të regjistruara (9,1 %); Rajoni i Prizrenit me 120 ndërmarrje të regjistruara (9,0 %); Rajoni i Gjilanit me 93 ndërmarrje të regjistruara (6,9 %); dhe Rajoni i Gjakovës me 90 ndërmarrje të regjistruara (6,7 %).

## Më shumë vizitorë në hotele në mars 2026 krahasuar me një vit më parë

Prishtinë, 8 maj- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e hotelerisë për muajin mars 2026.
Në këtë muaj, numri i vizitorëve në hotele ishte 46 649 prej tyre vizitorë vendorë ishin 19 180 dhe vizitorë të jashtëm ishin 27 469.
Krahasuar me muajin mars të vitit 2025 (sa ishin 40 239 vizitorë) pati rritje të numrit të përgjithshëm të vizitorëve në hotele për 15,9 %.
Numri i net-qëndrimeve ishte 94 804, prej tyre 52 226 (55, 0 %) nga vizitorët e jashtëm dhe 42 578 (ose 44,9 %) vendorët e brendshëm.
Sa u përket vizitorëve të huaj, krahasuar me periudhën paraprake (mars 2025) pati një rritje të vizitorëve për 9,1 %.
Në total, 27 469 vizitorë të huaj, nga të cilët numri më i madh ishte nga: Shqipëria, Gjermania, Turqia, Zvicra etj.



# ‘FURIA EPIKE’ QË NDRYSHOI BOTËN




Furia epike, ose lufta kundër Iranit nuk i dha goditjen vendimtare regjimit. Dhe mes Hormuzit, Gjirit të copëtuar, çarjeve transatlantike dhe zinxhirëve të furnizimit që duhen rindërtuar, çmimi i konfliktit është tashmë shumë i lartë

Nga Guido OLIMPIO *dhe* *Giuseppe Sarcina*

“Furia epike” e Donald Trumpit nuk solli ndryshimin e regjimit në Iran, por tronditi ekuilibrat strategjikë dhe ekonomikë. Asnjë sektor nuk ka kaluar i padëmtuar përmes kësaj stuhie.

## Atlantiku më i gjerë

Mënyra se si Trumpi e nisi dhe më pas e drejtoi luftën ka thelluar tensionet mes dy brigjeve të Atlantikut. Vendet europiane ankohen se nuk janë konsultuar. Presidenti amerikan është kundërpërgjigjur duke kërcënuar të tërheqë mijëra ushtarë nga Gjermania, Italia dhe Spanja.

Është një çarje që mund të riparohet? Prova më e afërt pritet në samitin e ardhshëm të NATO, më 7 dhe 8 korrik në Turqi.

Por është gjerësisht e ndarë ideja se konflikti ka përshpejtuar planin për t’i dhënë Europës një rol politik më autonom, e kuptuar në një kuptim më të gjerë sesa vetëm BE. Mbështetësit kryesorë të këtij procesi janë Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Gjermania.

## Furia epike dhe nyjet ushtarake

Dihej, dhe megjithatë ata ecën përpara: vetëm aviacioni nuk mund ta gjunjëzojë armikun, edhe nëse shkakton dëme shkatërrimtare. Aq më tepër kur kundërshtari është përgatitur prej dekadash për këtë provë.

Pasdaranët kanë përshtatur sistemin e tyre duke marrë parasysh atë që ndodhi në konfliktin e qershorit. Zinxhiri i komandës ka vazhduar të funksionojë pavarësisht humbjes së figurave kyçe; përdorimi i kombinimit dronë-raketa u ka lejuar iranianëve të mbajnë nën shënjestër bazat amerikane, infrastrukturat energjetike dhe fqinjët e Gjirit.

Ata nuk kishin nevojë të fitonin; për ta mjaftonte të rezistonin. Dhe e bënë këtë, ndoshta duke fshehur edhe përçarjet e brendshme, duke luajtur me nacionalizmin e përzier me parimet revolucionare dhe duke përdorur represionin. Angazhimi ushtarak ka konsumuar rezerva municionesh shumë të kushtueshme, ka bërë të qartë se ombrella kundër-raketore ka boshllëqet e saj dhe ka zbuluar një nënvlerësim befasues të boshtit mes mullahëve dhe gardianëve.

## Gjeografia

Gjeografia i ka shërbyer mbrojtjes iraniane dhe ka bërë të mundur rikthimin e shantazhit të Hormuzit.

Ujërat e cekëta dhe hapësirat e kufizuara kanë favorizuar manovrat e pasdaranëve, të vendosur për të imponuar kontrollin mbi Ngushticën. Zonat malore kanë shtuar mbrojtjen e bunkerëve ku janë fshehur lëshuesit, raketat dhe uraniumi i pasuruar.

Amerikanët dhe izraelitët kanë hedhur tonelata bombash mbi objektivat, kanë dobësuar me siguri aparatet, por nëse janë të vërteta disa rrjedhje informacioni kanë ndikuar vetëm pjesërisht mbi sitet atomike.

Dhe Tehrani ka mbajtur më pas si rezervë një kartë të dytë, gjithmonë të lidhur me skenarët gjeografikë: Detin e Kuq. Nëse luftimet do të rifillonin, është e mundshme ndërhyrja e Houthit-ëve nga Jemeni, të aftë për të kërcënuar kalimin e dytë jetik, atë që çon drejt Kanalit të Suezit.

## Monarkitë e përçara

Monarkitë e Gjirit duken të përçara dhe Irani po bën gjithçka për ta thelluar këtë përçarje. Nuk është rastësi që ka vënë vazhdimisht në shënjestër Emiratet e Bashkuara Arabe, tashmë të konsideruara si mbështetësi rajonal i Izraelit dhe promovues të një linje të ashpër kundër ajatollahëve.

Qëndrimi i Abu Dhabit ka shkaktuar pasoja brenda konfederatës së mini-shteteve, disa emirë kërkojnë stabilitet dhe jo plumba, ndërsa ka thelluar kontrastet me Arabinë Saudite, kundër aventurave dhe e gatshme, pavarësisht gjithçkaje, për dialog me Iranin.

I ngjashëm është edhe qëndrimi i Katarit dhe Omanit, prej kohësh ndërmjetësues, ashtu si edhe i Egjiptit, një regjim që ka humbur miliarda për shkak të uljes së trafikut detar.

## Anijet dhe nafta

Iranianët janë gjendur duke manovruar një instrument presioni të papritur në prag të konfliktit: hapjen ose mbylljen e Ngushticës së Hormuzit. Nga ai kalon rreth 20% e nevojës botërore për gaz dhe naftë. Për periudhën e pasluftës do të shtrohen dy çështje.

E para ka të bëjë, natyrisht, me rikthimin e furnizimeve. Qarkullojnë shumë parashikime. Më të besueshmet vlerësojnë se do të duhet pritur deri në shtator për t’u rikthyer, pak a shumë, në normalitet. Megjithatë, do të duhet parë në çfarë kushtesh. A do të jenë vërtet pasdaranët në gjendje të imponojnë një tarifë për çdo cisternë nafte?

Në çdo rast, dhe kjo është çështja e dytë, nga tani e tutje do të lëkundet një tjetër parim themelor i së drejtës: liria e lundrimit në ujërat ndërkombëtare.

## Tronditja ekonomike

Lufta në Iran përfaqëson goditjen e tretë për ekonominë botërore në pak vite. Ajo erdhi pas COVID-19 në vitin 2020 dhe pas pushtimit rus të Ukrainës në vitin 2022.

Qeveritë dhe industritë, sidomos ato perëndimore, janë sërish të detyruara të rishikojnë zinxhirët e furnizimit për lëndët e para thelbësore.

Europa, duke nisur nga Italia, po përfundonte ripozicionimin energjetik, pasi kishte ndërprerë pothuajse plotësisht blerjet e naftës dhe gazit nga Rusia. Ekonomia rikthehet të përballet me gjeopolitikën.

Sytë janë drejtuar nga Afrika e Veriut, Azerbaixhani, Kazakistani dhe vende të tjera për të zëvendësuar sidomos gazin që për një periudhë të vështirë për t’u përcaktuar, nuk do të vijë më nga Katari dhe monarkitë e tjera të Gjirit.

Natyrisht, hapet edhe një mundësi tjetër zgjerimi për SHBA, eksportues i madh i gazit të lëngshëm. Në teori, ky do të ishte gjithashtu një test për shtetet e Bashkimit European, të cilat mund të paraqiteshin në treg me blerje të përbashkëta, siç rekomandohet nga Raporti Draghi.

## Siguria dhe prodhimi

Por nuk bëhet fjalë vetëm për hidrokarburet.

Nga Hormuzi kalojnë shumë lëndë të tjera të para ose gjysmëprodukte themelore: alumin, helium, squfur, nikel, kobalt, bakër, plastikë, produkte petrokimike, plehra kimikë.

Në horizont shfaqen vështirësi që do të prekin një spektër të gjerë sektorësh: elektronikë, rezonancë magnetike, farmaceutikë, automobilistikë, letër, qelq, ambalazhim, tekstil, kimi dhe shumë të tjerë.

Prandaj bëhet gjithnjë e më qendrore tema e asaj që quhet “siguria ekonomike”.

Kompanitë, veçanërisht shumëkombëshet, kanë nisur të konsultohen me qeveritë për të identifikuar rrugë të reja furnizimi dhe, në të njëjtën kohë, për të studiuar mënyrën se si t’i bëjnë ato të sigurta.

Si pasojë, ky proces ka prekur tashmë edhe primet e sigurimeve detare, të cilat në disa raste janë pesëfishuar. / Corriere della Sera – Bota.al




# Sport




## Xhaka, lojtari i sezonit te Sunderlandi: Jam krenar dhe mirënjohës



**Sunderland, 8 maj** - Granit Xhaka është zgjedhur futbollisti më i mirë i sezonit te skuadra e tij, Sunderland. Xhaka është transferuar verën e kaluar dhe menjëherë është bërë shtylla e ekipit anglez, duke treguar performanca fantastike.
Pas marrjes së çmimit, Xhaka ka thënë se është krenar për këtë vlerësim. "Njerëzit e vunë në dyshim këtë transferim. Unë i besova vizionit. Sot, duke qëndruar këtu si 'Lojtari i Vitit', nuk ndiej asgjë tjetër përveç krenarisë, mirënjohjes dhe urisë për më shumë. Për tifozët, faleminderit që më pranuat që nga dita e parë, për pasionin tuaj, besimin dhe mbështetjen e pakushtëzuar në çdo betejë. Ky klub do të thotë gjithçka për mua", ka shkruar Xhaka në "Instagram".

# DRITA SOT MUND TË SHPALLET KAMPIONE E SUPERLIGËS



**Prishtinë, 8 maj** - Katër xhiro para përfundimit të kampionatit në Superligën e Kosovës në futboll, gara për titullin mund të vendoset në sot (e shtunë). Drita kampione e pret Ballkanin, në derbin e javës së 33, në duelin direkt për titull kampioni, ndërmjet të parit e të dytit në tabelë. Gjilanasit udhëheqin Superligën me 63 pikë, tetë më shumë se skuadra nga Suhareka dhe në rast të fitores të shtunën, mund ta fitojnë titullin e kampionit. Kjo pasi skuadra e Dritës, do të kishte 11 pikë më shumë se Ballkani, kur do të mbeteshin vetëm edhe tri xhiro apo nëntë pikë në lojë. Drita është në seri prej tri fitoreve rresht në ligë, ndërsa në tetë duelet e fundit i ka fituar shtatë. Por kundër Ballkanit në këtë edicion nuk ka fituar asnjë ndeshje. Tri herë janë takuar gjatë këtij edicioni Drita e Ballkani, por suharekasit i kanë fituar të tri duelet. Derbi i javës së 33, luhet sot (e shtunë), duke filluar nga ora 16:00 në Gjilan. Ndeshjet e tjera të kësaj jave janë kryesisht të rëndësisë për mbetje në elitë dhe sigurimi i barazhit. Sot, Drenica e cila zë vendin e shtatë me 41 pikë, e pret Gjilanin në Skenderaj, me gjilanasit që kanë pak gjasa për Evropë. Ndërsa nesër (e diel), Ferizaj i parafundit në tabelë i bën konak Malishevës, ndërsa Llapi luan duelin direkt për mbijetesë ndaj Dukagjinit në Podujevë.

# PREMIERLIGA DOMINON NË FINALET E GARAVE EVROPIANE KËTË SEZON

**Londër, 8 maj** - Skuadrat angleze kanë arritur në finalet e tri garave të ndryshme evropiane brenda të njëjtit sezon për herë të parë në histori. Pasi Arsenali ka siguruar vendin në finalen e Ligës së Kampionëve duke mposhtur Atletico Madridin, Aston Villa dhe Crystal Palace kanë bërë të njëjtën gjë në garat e tyre përkatëse më vonë gjatë javës. Skuadra e Unai Emery, Aston Villa, ka përmbysur humbjen 1-0 nga ndeshja e parë duke mposhtur Nottingham Forestin me rezultat të përgjithshëm 4-1 të enjten dhe ka siguruar finalen e Ligës së Evropës kundër skuadrës gjermane SC Freiburg në Stamboll më 20 maj.
Njëkohësisht me triumfin e Villas, Crystal Palace ka pasuar fitoren 3-1 ndaj Shakhtar Donetsk shtatë ditë më parë me një tjetër sukses 2-1 ndaj skuadrës ukrainase në Selhurst Park në ndeshjen e kthimit. Ata do të përballen me Rayo Vallecano në finalen e Ligës së Konferencës më 27 maj. Liga e Konferencës është prezantuar pesë vjet më parë, duke u bërë gara e tretë evropiane për klube pas përfundimit të UEFA Cup Winners' Cup në vitin 1999. Arritja në të tri finalet pothuajse ka ndodhur edhe sezonin e kaluar, kur Chelsea kishte fituar Ligës së Konferencës dhe Tottenham Hotspur ka mposhtur Manchester United në finalen e Ligën së Evropës.
Por skuadra e fundit angleze e mbetur në Ligën e Kampionëve ishte Arsenali, e cila është eliminuar në gjysmëfinale nga fituesi i mëvonshëm Paris Saint-Germain.
Premier League ka pasur edhe më parë të paktën tri skuadra në finalet e Ligës së Kampionëve dhe Ligën e Evropës. Në vitin 2021, Kai Havertz kishte shënuar golin e vetëm teksa Chelsea pati mposhtur Manchester Cityn në një finale tërësisht angleze të Ligës së Kampionëve, ndërsa



Manchester United ka humbur finalen e Ligës së Evropës. Ndërsa në vitin 2019, Liverpooli kishte mposhtur Tottenham Hotspur në finalen e Ligës së Kampionëve në të njëjtën javë kur Chelsea kishte fituar ndaj Arsenalit në finalen e Ligës së Evropës në Baku.
Ndërkohë, në vitin 2006 skuadrat angleze kishin humbur të dyja finalet, kur Arsenali ishte mposhtur në Ligën e Kampionëve nga Barcelona dhe Middlesbrough nga Sevilla në finalen e Kupës së UEFA-s. Megjithatë, duhet të kthehemi më shumë se 20 vjet prapa për të gjetur sezonin e mëparshëm kur klubet angleze kanë fituar dy nga tri garat e disponueshme.
Në vitin 1984, Liverpooli kishte fituar Kupën e katërt Evropiane duke mposhtur AS Roma, ndërsa Tottenham Hotspur pati mposhtur Anderlecht për të fituar për herë të dytë Kupën e UEFA-s.
Liverpool kishte fituar gjithashtu Kupën Evropiane në vitin 1981 me fitore 1-0 ndaj Real Madrid në Paris, ndërsa skuadra e Bobby Robson, Ipswich Town, pati mposhtur AZ Alkmaar në finalen e Kupës së UEFA-së të po atij viti.
Italia ka siguruar përfaqësues në të gjitha finalet disa herë, më së fundmi në vitin 2023, edhe pse klubet italiane kanë humbur të tria finalet - Inter Milan në Ligën e Kampionëve, AS Roma në Ligën e Evropës dhe Fiorentina në Ligën e Konferencës.
Serie A ka fituar dy nga tri finalet në sezonin 1993-94. AC Milan kishte fituar Ligën e Kampionëve dhe Interi Kupën e UEFA-së, ndërsa Parma pati humbur ndaj Arsenalit në Kupën e Fituesve të Kupave.
Ata gjithashtu kanë fituar dy nga tri finalet në sezonet 1992-93 dhe 1988-89. Në sezonin 1989-90, megjithatë, një epokë kulmore për futbollin italian, klubet e Serie A kishin fituar të tria garat: Milani ishte shpall kampion evropian, Juventusi kishte mposhtur Fiorentinën për të fituar Kupën UEFA dhe Sampdoria pati fituar Kupën e Fituesve të Kupave.
Klubet spanjolle kishin arritur tri finale në sezonin 1985-86, me Real Madridin që kishte fituar Kupën UEFA, ndërsa Barcelona pati humbur finalen e Kupës Evropiane dhe Atletico Madrid kishte përfunduar nënkampion në Kupën e Fituesve të Kupave.

## Real Madridi nis procedurat disiplinore kundër Valverdes dhe Tchouamenit



**Madrid, 8 maj** - Real Madrid ka lëshuar një deklaratë zyrtare pas lajmit për një sherr në mes të Aurelien Tchouameni dhe Federico Valverde, ku ky i fundit ka përfunduar në spital.
Në deklaratën e lëshuar nga klubi spanjoll është thënë se ka hapur procedurë ligjore kundër dy lojtarëve. "Real Madrid CF njofton se, pas ngjarjeve që ndodhën këtë mëngjes në stërvitjen e ekipit të parë, ka vendosur të fillojë procedurat disiplinore kundër lojtarëve tanë Federico Valverde dhe Aurelien Tchouameni. Klubi do të njoftojë zgjidhjet për të dyja rastet në kohën e duhur, pasi të jenë përfunduar procedurat e brendshme përkatëse", ka njoftuar Real Madridi.Lidhur me situatën e krijuar ka reaguar mesfushori i Realit, Fede Valverde. Ai ka thënë se debati me Tchouamenin ka ndodhur për shkak të lodhjes dhe frustrimit dhe gjatë tij, aksidentalisht i ka shkaktuar lëndime vetes duke goditur një tavolinë. Valverde ka theksuar se nuk ka pasur asnjë lloj dhunë ndaj tij nga Tchouameni, duke kërkuar falje për situatën.

**N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.**
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail.. contact@pallatirinise.com
www. pallatirinise.com

Nr. 1/968 Dt 08.05.2026

Në përputhje me nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, në bazë të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MFPT nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, në bazë të nenit 12 të Rregullores së marrëdhënies së punës nr. 1/1338 datë 14.11.2024, në bazë të Rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës nr. 1/1373, datë 22.11.2024 dhe pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur, Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë, me datën : 08.05.2026, merr këtë:

## KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të lirë të punës

**I. Titulli i vendit të punës:**

**Këshilltar i Kryeshefit Ekzekutiv** (një vend pune);

**II. Lartësinë e pagës mujore për vendin e punës;**

- Paga bazë bruto është 836,5 €UR, e cila rrjedh nga një koeficient prej 3.5, me vlerë monetare të koeficientit 239.00 €.
- I/E punësuara përfiton edhe shtesë për përvojë pune, e cila llogaritet në masën 0.5% për çdo vit të përvojës së plotë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përfiton gjithashtu shtesën për shujtë të ngrohtë, sipas politikave të ndërmarrjes.

**III. Përmbledhje e shkurtër të përshkrimit të punës, në të cilin përshkruhet qëllimi i vendit të punës, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë kryesore;**

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Ofron ndihmë Kryeshefit Ekzekutiv në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të ndërmarrjes;
- Harton draft dokumente sipas nevojës dhe kërkesës së Kryeshefit Ekzekutiv;
- Përgadit materiale të komunikimit për Kryeshefin Ekzekutiv në lidhje me çështjet e rëndësishme dhe zhvillimet e fundit sipas kërkesës;
- Harton shkresa për nevojat e zyrës së Kryeshefit Ekzekutiv;
- Angazhohet në konsultime një-në-një ose në grup për të kuptuar nevojat specifike, sfidat dhe qëllimet e zyrtarëve brenda Ndërmarrjes;
- Ndihmon në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe procedurave të reja për të forcuar integritetin dhe përputhshmërinë me ligjin;
- Ofron këshilla për stafin e ndërmarrjes në lidhje me politikat dhe procedurat e Ndërmarrjes;
- Kryen analiza të thella duke bërë vlerësime për situatën aktuale dhe ofron rekomandime për përmirësim;
- Komunikon qartë idetë dhe rekomandimet , si verbalisht ashtu edhe me shkrim;
- Kryen çdo detyrë të përcaktuara nga Kryeshefi Ekzekutiv në lidhje me menaxhimin e përgjithshëm të Ndërmarrjes.

**IV. Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës;**

- Diplomë universitare;
- Përvojë profesionale së paku 2 vjeçare;
- Shkathtësi të dëshmuara organizative;
- Shkathtësi të shkëlqyera të komunikimit dhe në të shkruar;
- Shkathtësi kompjuetrike në Microsoft Office;
- E preferuar njohja e gjuhëve të huaja

**V. Specifikimi i dokumenteve/dëshmive përkatëse për vërtetimin e përmbushjes së kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës;**

- Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:
- Formulari i kërkesës për punësim (aplikimi);
- Kopje e letërnjoftimit; CV; Certifikata e lindjes. Letër motivimi;
- Dëshmitë mbi Shkollimin dhe kualifikimin profesional e noterizuar;
- Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e noterizuar.
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);
- Lista e dokumenteve të dorëzuara.

**VI. Informata nëse emërimi është me afat të caktuar apo të pacaktuar, dhe kohëzgjatja e periudhës provuese:**

- **Lloji i kontratës:** Kontratë në kohë të caktuar për periudhë prej gjashtë (6) muajsh, me mundësi vazhdimi.
- **Periudha provuese:** 6 muaj, gjatë të cilëve, punëdhënësi dhe i punësuari mund të ndërpresin marrëdhënien e punës me njoftim paraprak prej 7 ditësh.

**VII. Datën dhe orën e saktë të përmbylljes së konkursit:**

- Konkursi është i hapur nga data 08.05.2026 deri me datën 22.05.2026.

**VIII. Mënyra e aplikimit në konkurs:**

- **Dokumentet e kërkuara:** *Të gjithë kandidatët duhet të skanojnë të gjitha dokumentet që kërkohen sipas pikës V dhe t'i dërgojnë ato, së bashku me kërkesën për punësim/aplikacionin, në adresën e-mailit: burimetnjerezore@pallatirinise.com.*
- **Kthimi i informacionit:** Njësia e Burimeve Njerëzore do të sigurojë informacion për pranimin e kërkesave për punësim/aplikacioneve.
- **Sqarime të tjera:** Njësia e burimeve njerëzore e institucionit publik ofron sqarime të nevojshme për kandidatët lidhur me kriteret e konkursit publik gjatë fazës së aplikimeve.

**IX. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:**

- Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet nëpërmjet testimit me intervistim (testim me gojë).
- Kalueshmëria është arritja e së paku 55 pikëve nga të gjitha fazat e konkursit.

**X. Kalendar i procedurës së rekrutimit:**

- Pas mbylljes së afatit të konkursit, njësia e burimeve njerëzore do të verifikojë aplikimet brenda 7 ditëve dhe do të konfirmojë përmbushjen e kritereve nga kandidatët.

**XI. Shënimi për aplikacionet e dërguara pas afatit:**

Aplikacionet e dërguara pas datës 22.05.2026 nuk do të shqyrtohen.

**N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.**
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail.. contact@pallatirinise.com
www. pallatirinise.com

Nr. ____________ Dt ____________

Na osnovu lana 8. Zakona o radu br. 03/L-212, clana 5. Administrativnog uputtva MFPT br. 01/2024 o regulisanju procedura konkursa u javnom sektoru, clana 12. Pravilnika o radnim odnosima br. 1/1338 od 14.11.2024, Pravilnika o unutranjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1/1373 od 22.11.2024, i nakon razmatranja podnesenog zahteva i dokumentacije, Izvrsni direktor J.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. iz Pristine,od : 08.05.2026, uzmite ovo:

## JAVNI KONKURS

Za popunjavnje upraznjenog mesta

**I.Naziv radnog mesta:**

Sluzbenik za javne nabavke(jedno radno mesto);

**II.Mesecna plata za radno mesto;**

- Bruto osnovna plata iznosi 836,50 sto je izvedeno iz koeficijenta 3,50 sa novcanom vrednoscu od 239,00€.
- Zaposleni takode ima koristi od bonusa za radno iskustvo, koji se obracunava po stopi od 0,5% za svaku godinu punog radnog iskustva, u skladu sa vazecim zakonskim propisima.On/ona takode ima koristi od bonuza za topli obrok, u skladu sa politikama kompanije.

**III.Kratak rezime opisa posla koji opisuje svrhu posla, kao i glavne duznosti i odgovornosti;**

Dužnosti i odgovornosti:

- Pruža pomoć generalnom direktoru u razvoju i sprovođenju politika preduzeća;
- Izrađuje dokumenta po potrebi i na zahtev generalnog direktora;
- Priprema komunikacione materijale za generalnog direktora u vezi sa važnim pitanjima i najnovijim dešavanjima po zahtevu;
- Izrađuje prepisku za potrebe kancelarije generalnog direktora;
- Učestvuje u individualnim ili grupnim konsultacijama kako bi razumeo specifične potrebe, izazove i ciljeve službenika u preduzeću;
- Pomaže u razvoju i sprovođenju novih politika i procedura radi jačanja integriteta i usklađenosti sa zakonom;
- Pruža savete zaposlenima u kompaniji u vezi sa politikama i procedurama kompanije;
- Sprovodi detaljne analize, procenjujući trenutnu situaciju i dajući preporuke za poboljšanje;
- Jasno saopštava ideje i preporuke, usmeno i pismeno;Obavlja sve poslove koje mu dodeli generalni direktor u vezi sa celokupnim upravljanjem kompanijom.

**IV. Opšti i specifični kriterijumi za posao;**

- Univerzitetska diploma;
- Najmanje 2 godine stručnog iskustva;
- Dokazane organizacione sposobnosti;
- Odlične komunikacijske i pisane veštine;
- Poznavanje rada na računaru u Microsoft Office-u;
- Poželjno je poznavanje stranih jezika.

**V. Specifikacija relevantnih dokumenata/dokaza kojima se dokazuje ispunjavanje opštih i specifičnih kriterijuma za posao;**

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za posao;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih. Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome sa stranih univerziteta moraju biti notarizovane od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije i overene.
- Dokaz o radnom iskustvu/potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, sa navođenjem radnog mesta i trajanja angažovanja na tom mestu;
- Izjave o penzijskim doprinosima (nisu potrebne za radna iskustva pre osnivanja Kosovskog penzionog fonda, kao i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili obavezni da uplaćuju u ovu instituciju);
- Potvrda nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da lice nije osuđivano za bilo koje krivično delo (ne starije od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja);
- Spisak dostavljenih dokumenata.

**VI. Informacije o tome da li je imenovanje na određeno ili neodređeno vreme i trajanje probnog perioda:**

- Vrsta ugovora: Ugovor na određeno vreme u trajanju od šest (6) meseci, sa mogućnošću produženja.
- Probni period: 6 meseci, tokom kojeg poslodavac i zaposleni mogu prekinuti radni odnos uz prethodno obaveštenje od 7 dana.

**VII. Tačan datum i vreme zatvaranja konkursa:**

- Konkurs je otvoren od 08.05.2026 do 22.05.2026.

**VIII. Kako se prijaviti na konkurs:**

- Potrebna dokumenta: Svi kandidati moraju skenirati sva dokumenta potrebna pod tačkom V i poslati ih, zajedno sa zahtevom/prijavom za zaposlenje, na imejl adresu: burimetnjerezore@pallatirinise.com.
- Povraćaj informacija: Jedinica za ljudske resurse će pružiti informacije o prijemu zahteva/prijava za zaposlenje.
- Ostala pojašnjenja: Jedinica za ljudske resurse javne ustanove pruža potrebna pojašnjenja kandidatima u vezi sa kriterijumima javnog konkursa tokom faze prijave.

**IX. Način evaluacije i kriterijumi bodovanja:**

- Evaluacija kandidata će se vršiti putem intervju testiranja (usmeno testiranje).
- Polaganje je postizanje najmanje 55 poena iz svih faza konkursa.

**X. Kalendar postupka zapošljavanja:**

- Nakon završetka roka za konkurs, jedinica za ljudske resurse će proveriti prijave u roku od 7 dana i potvrditi da kandidati ispunjavaju kriterijume.

**XI. Napomena o prijavama podnetim nakon roka:**

- Prijave podnete nakon 22.05.2026 neće biti razmatrane.

N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail.. contact@pallatirinise.com
www. pallatirinise.com
Nr. 1/972 Dt 08.05.2026

Në përputhje me nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, në bazë të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MFPT nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, në bazë të nenit 12 të Rregullores së marrëdhënies së punës nr. 1/1338 datë 14.11.2024, në bazë të Rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës nr. 1/1373, datë 22.11.2024 dhe pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur, Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë, me datën : 08.05.2026, merr këtë:

## KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e vendit të lirë të punës

**I. Titulli i vendit të punës:**
**Përgjegjës i Financave** (një vend pune);

**II. Lartësinë e pagës mujore për vendin e punës;**
- Paga bazë bruto është 1.003,8 €UR, e cila rrjedh nga një koeficient prej 4.2, me vlerë monetare të koeficientit 239.00 €.
- I/E punësuara përfiton edhe shtesë për përvojë pune, e cila llogaritet në masën 0.5% për çdo vit të përvojës së plotë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përfiton gjithashtu shtesën për shujtë të ngrohtë, sipas politikave të ndërmarrjes.

**III. Përmbledhje e shkurtër të përshkrimit të punës, në të cilin përshkruhet qëllimi i vendit të punës, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë kryesore;**
Detyrat dhe Përgjegjësitë:
- Implementon politikat dhe procedurat e brendshme për kontrollin financiar dhe menaxhimin e buxhetit,pasurive dhe detyrimeve të organizatës;
- Ndihmon në përgaditjen e raporteve për gjendjen financiare të organizatës për ZKFTh;
- Verifikon dhe kontrollon regjistrime dhe deklaratat tatimore sipas afateve ligjore të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Siguron që transaksionet të kryhen në mënyrë të rregullt dhe të dokumentuara;
- Përgadit dhe zbaton urdhër-transferet bankare për pagesa të brendshme dhe të jashtme;
- Monitoron detyrimet ndaj furnitorëve dhe raporton për gjendjen e tyre ;
- Organizon dhe zhvillon trajnimet për stafin lidhur me proceset financiare të departamentit;
- Kontribuon në hartimin e planeve strategjike dhe parashikimeve financiare dhe monitoron sistemet e menaxhimit financiar;
- Verifikon pagat e punonjësve të Pallatit të Rinisë ,duke u kujdesur për shtesat në pagë bazuar në rregulloret e brendshme të ndërmarrjes dhe legjislacionin në fuqi;
- Menaxhon dhe udhëheqë stafin brenda departamentit, duke përcaktuar objektivat dhe ofruar këshillim;
- Kryen detyra të tjera të cilat kërkohen nga mbikëqyrsi për të siguruar funksionimin e drejtë të departamentit;
- Raporton dhe bashkëpunon me Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit dhe Kryeshefin Ekzekutiv për çështje të rëndësishme financiare dhe administrative.

**IV. Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës;**
- Diplomë nga Fakulteti Ekonomik;
- Përvojë 3 vjeçare në menaxhim financiar dhe në kontabilitet;
- Njohje e sektorit publik/lokal;
- Njohje e avancuar e aplikacioneve të Microsoft Office dhe Internetit;
- Njohuri për kontabilitetin akrual,financiar dhe SNRF;
- Njohuri e avancuar mbi ligjet e aplikueshme të taksave dhe të tatimeve në RKS;
- Bënë përcjelljen e pagesave të qirramarrësve të hapsirave afariste dhe të shfrytëzuesve dhe të programeve të ndryshme (llogarive të arkëtueshme ) ;
- Bënë përcjelljen e pagesave të furrnitorëve dhe tatimeve (llogaritë e pagueshme);
- Mirëmban dokumentacionet financiare në bazë të kërkesave ligjore;
- Kryen punë dhe detyrave të tjera sipas kërkesave të mbikqyrësit;

**V. Specifikimi i dokumenteve/dëshmive përkatëse për vërtetimin e përmbushjes së kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës;**
- Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:
- Formulari i kërkesës për punësim (aplikimit);
- Kopje e letërnjoftimit; CV; Certifikata e lindjes. Letër motivimi;
- Dëshmitë mbi Shkollimin dhe kualifikimin profesional e noterizuar;
- Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e noterizuar.
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);
- Lista e dokumenteve të dorëzuara.

**VI. Informata nëse emërimi është me afat të caktuar apo të pacaktuar, dhe kohëzgjatja e periudhës provuese:**
- **Lloji i kontratës**: Kontratë në kohë të caktuar për periudhë prej gjashtë (6) muajsh, me mundësi vazhdimi.
- **Periudha provuese**: 6 muaj, gjatë të cilëve, punëdhënësi dhe i punësuari mund të ndërpresin marrëdhënien e punës me njoftim paraprak prej 7 ditësh.

**VII. Datën dhe orën e saktë të përmbylljes së konkursit:**
- Konkursi është i hapur nga data 08.05.2026 deri me datën 22.05.2026.

**VIII. Mënyra e aplikimit në konkurs:**
- **Dokumentet e kërkuara:** ***Të gjithë kandidatët duhet të skanojnë të gjitha dokumentet që kërkohen sipas pikës V dhe t'i dërgojnë ato, së bashku me kërkesën për punësim/aplikacionin, në adresën e-mailit: burimetnjerezore@pallatirinise.com.***
- **Kthimi i informacionit:** Njësia e Burimeve Njerëzore do të sigurojë informacion për pranimin e kërkesave për punësim/aplikacioneve.
- **Sqarime të tjera:** Njësia e burimeve njerëzore e institucionit publik ofron sqarime të nevojshme për kandidatët lidhur me kriteret e konkursit publik gjatë fazës së aplikimeve.

**IX. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:**
- Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet nëpërmjet testimit me shkrim dhe intervistim (testim me gojë).
- Kalueshmëria është arritja e së paku 55 pikëve nga të gjitha fazat e konkursit.

**X. Kalendari i procedurës së rekrutimit:**
- Pas mbylljes së afatit të konkursit, njësia e burimeve njerëzore do të verifikojë aplikimet brenda 7 ditëve dhe do të konfirmojë përmbushjen e kritereve nga kandidatët.

**XI. Shënimi për aplikacionet e dërguara pas afatit:**
Aplikacionet e dërguara pas datës 22.05.2026 nuk do të shqyrtohen

N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail.. contact@pallatirinise.com
www. pallatirinise.com
Nr. ______________ Dt______________

Na osnovu lana 8. Zakona o radu br. 03/L-212. clana 5. Administrativnog uputtva MFPT br. 01/2024 o regulisanju procedura konkursa u javnom sektoru, clana 12. Pravilnika o radnim odnosima br. 1/1338 od 14.11.2024, Pravilnika o unutranjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1/1373 od 22.11.2024, i nakon razmatranja podnesenog zahteva i dokumentacije, Izvrsni direktor J.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. iz Pristine,od : 08.05.2026, uzmite ovo:

## JAVNI KONKURS
Za popunjavnje upraznjenog mesta

**I.Naziv posla:**

Finansijski menadžer (jedno radno mesto);

**II. Mesečna plata za radno mesto;**
- Bruto osnovna plata je 1.003,8 €, što je izvedeno iz koeficijenta 4.2, sa novčanom vrednošću od 239,00 €.
- Zaposleni takođe ima koristi od bonusa za radno iskustvo, koji se obračunava po stopi od 0,5% za svaku godinu punog radnog iskustva, u skladu sa važećim zakonskim propisima. On/ona takođe ima koristi od bonusa za topli obrok, u skladu sa politikama kompanije.

**III. Kratak rezime opisa posla, koji opisuje svrhu posla, kao i glavne dužnosti i odgovornosti;**
**Dužnosti i odgovornosti:**
- Sprovodi interne politike i procedure za finansijsku kontrolu i upravljanje budžetom, imovinom i obavezama organizacije;
- Pomaže u pripremi izveštaja o finansijskom stanju organizacije za Poresku upravu;
- Proverava i kontroliše poreske evidencije i deklaracije u skladu sa zakonskim rokovima Poreske uprave Kosova;
- Osigurava da se transakcije obavljaju na redovan i dokumentovan način;
- Priprema i izvršava bankovne naloge za interna i eksterna plaćanja;
- Prati obaveze prema dobavljačima i izveštava o njihovom statusu;
- Organizuje i sprovodi obuku zaposlenih u vezi sa finansijskim procesima odeljenja;
- Doprinosi izradi strateških planova i finansijskih prognoza i prati sisteme finansijskog upravljanja;
- Proverava plate zaposlenih u Palati mladih, brinući se o povećanju plata na osnovu internih propisa kompanije i važećih zakona;
- Upravlja i vodi osoblje u odeljenju, postavljajući ciljeve i pružajući savete;
- Obavlja i druge poslove na zahtev supervizora kako bi se osiguralo pravilno funkcionisanje odeljenja;
- Izveštava i sarađuje sa glavnim finansijskim i blagajničkim direktorom i glavnim izvršnim direktorom o važnim finansijskim i administrativnim pitanjima.

**IV. Opšti i specifični kriterijumi za posao;**
- Diploma Ekonomskog fakulteta;
- 3 godine iskustva u finansijskom menadžmentu i računovodstvu;
- Poznavanje javnog/lokalnog sektora;
- Napredno poznavanje Microsoft Office aplikacija i interneta;
- Poznavanje obračunskog. finansijskog i MSFI računovodstva;
- Napredno poznavanje važećih poreskih zakona i poreza u RKS;
- Praćenje plaćanja zakupaca i korisnika poslovnog prostora i različitih programa (potraživanja);
- Praćenje plaćanja dobavljača i poreza (obaveze);
- Vođenje finansijske dokumentacije na osnovu zakonskih zahteva;
